

LIGJ
Nr. 67/2024

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 10 440, DATË 7.7.2011,
“PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 26 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Shkeljet e këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

a) zhvilluesi i një projekti, i cili listohet në shtojcat I dhe II të këtij ligji, nëse operon pa u pajisur me vendim për VNM-në paraprake, sipas parashikimit të nenit 8 të këtij ligji, ose me deklaratë mjedisore, sipas parashikimit të nenit 9 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 65 000 (gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë deri në 650 000 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë dhe me pezullimin e punimeve;

b) mospërmbushja dhe mosrespektimi i kushteve nga zhvilluesi i projektit:

i. për vendimin për VNM-në paraprake dënohet me gjobë nga 65 000 (gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë deri në 260 000 (dyqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë;

ii. për deklaratë mjedisore dënohet me gjobë nga 65 000 (gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë deri në 650 000 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.”.

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Gjoha e vendosur në zbatim të këtij neni përbën titull ekzekutiv pas shterimit të ankimit administrativ, sipas përcaktimeve në Kodin e Procedurave Administrative. Gjoha paguhet brenda 10 ditëve kalendarike nga data kur është njoftuar kundërvajtësi për vendimin e dënimit me gjobë që përbën titull ekzekutiv. Në rast mosekzekutimi vullnetar, për ekzekutimin e saj ngarkohet zyra e përmbartimit, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurave Civile dhe në ligjin për kundërvajtjet administrative.”.

Neni 2

Pas nenit 30 shtohet neni 30/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 30/1

“1. Aktet e emërtuara “Vendim për VNM paraprake”/“Vendim për VNM të thelluar”/ “Deklaratë mjedisore”, për të cilat aplikimi është kryer në Qendrën Kombëtare të Licencimit, në zbatim të vendimit nr. 13, datë 4.1.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis”, të shfuqizuar, dhe rezultojnë të regjistruara aktive në Regjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Licencave, shfuqizohen për shkak të moskategorizimit si leje, licencë apo autorizim, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Biznesit identifikojnë aktet e emërtuara si “Vendim për VNM paraprake”/“Vendim për VNM të thelluar”/ “Deklaratë

mjedisore”, të regjistruara si leje mjedisore, dhe kalimi në statusin “shfuqizuar për shkak të ligjit” bëhet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 4.7.2024.

**Shpallur me dekretin nr. 258, datë 24.7.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.**